

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për krime të rënda, kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajser Skenderi me anëtarët e trupit – gjyqtarët: Refki Piraj dhe Artan Sejrani, me procesmbajtësen Sheqere Braha, në çështjen penale kundër të akuzuarve E. S. nga Prizreni, për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KP, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1 të KP dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KP, L. S. nga Prizreni, për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë në ndihmë nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 33 të KP, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1 të KP, A. F. dhe E. M. për shkak të veprës penale lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.1.p.1.1. lidhur me nenin 31 të KP, duke vendosur sipas aktakuzës së PSH në Prizren PP.nr.2/15 të datës 03.03.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Genc Nixha, të akuzuarit E. S. dhe mbrojtësit të tij avokat S. M., L. S. dhe mbrojtësit të tij avokat F. Sh., të akuzuarve E. M. dhe A. F., më datën 05.01.2016, muarr dhe publikisht e shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

I.E. S., nga i ati E. dhe e ëma L., e lindur R., data e lindje... në Prizren, e ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në paraburgim- arrest shtëpiak prej datës 09.01.2015 gjerë më 05.05.2015.

II.L. S., nga i ati E. dhe e ëma L., e lindur R., data e lindjes ..., në Prishtinë, e ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në paraburgim- arrest shtëpiak prej datës 09.01.2015 gjerë më 05.05.2015.

III.E. M., nga i ati R. dhe e ëma H. – e lindur F. Data e lindjes ... në Prizren, e ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

IV.A. F., nga i ati V. dhe e ëma Sh., e lindur R., data e lindjes... në fshatin V., tani me banim në Prizren, i pa martuar, e ka të kryer shkollën fillore, punon në furrë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

I akuzuari E. S.:

1. Se më datën 08.01.2015 rrethë orës 22,25 minuta në Prizren në rrugën “T.” saktësisht tek Universiteti “F.” me dashje ndërmerr veprime me qëllim të privimit nga jeta të personit tjetër - të dëmtuarëve D. P., E. S., A. K. dhe U. F., në atë mënyrë që pasi i akuzuari L. S. kishte pas një mosmarrëveshje me personat E. M. dhe A. F. në Lagjen “T.” në afërsi të shkollës së mesme “R. A.,” ku ka ardhur deri te një përleshje mes tyre ku pas së cilës i akuzuari L. kthehet në shtëpinë e tij, lajmëron vëllaun E. S. për sulmin fizik, pas së cilës që të dy automjetin e markës WV-Buba me ngjyrë të kaltër metalike me targa të regjistrimit xx – xxx – xx, të cilën e ka drejtuar i akuzuari L. S. kanë dalë në qytet për ti kërkuar të akuzuarit E. M., A. F. dhe të dëmtuarin U. F. dhe kur kanë mbërritur në afërsi të pompës së benzinës “H.” vërejnë automjetin e të dëmtuarit U. F., i cili ka qenë në shoqëri me D. P., E. S. dhe A. K. dhe pasi që të njejtit kanë dalë nga restoranti, kanë hyrë në automjetin e markës “Fiat Punto” me ngjyrë hiri me targa të regjistrimit xx-xxx – xx, janë nisur në drejtim të rrugës “T.” të akuzuarit me automjetin e tyre iu janë afruar vizavijë me automjetin e të dëmtuarëve ku i akuzuari E. S. i cili ishte i ulur në pjesën e pasme të veturës nxjerrë revolen, hap dritaren e automjetit dhe gjuan në drejtim të veturës së të dëmtuarëve 7 herë, duke e goditur të dëmtuarin D. P., në krahun e majtë dhe me të shpejtë largohet nga vendi i ngjarjes, ndërsa vetura e të dëmtuarëve të cilën e drejtonte A. K. nga goditja me armë është skajuar ndërsa i dëmtuari D. P. së pari është dërguar në Qendrën emergjente pas së cilës me automjetin e ndihmës së shpejtë është dërguar në spital ku edhe i është dhënë ndihma e parë, ndërsa të dëmtuarit e tjerë kanë qëndruar në vendin e ngjarjes, duke e pritur policinë.

Këso dore ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KP.

2. Se më datë, kohë dhe vend të njejtë si ne dispozitivin nen I te ketij aktgjykimi i akuzuari E. S. ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve në atë mënyrë që natën kritike pas një mosmarrëveshje të mëparshme e merr automjetin e markes WV- Buba me ngjyrë metalike me targa të regjistrimit xx – xxx – xx të cilin e drejton i akuzuari L. dhe kur mbrinë në afërsi të pompës së benzinës “H.” vëren automjetin e të dëmtuarit U. F. i cili ka qenë në shoqëri me D. P., E. S. dhe A. K. dhe pasi që të njejtit kanë dalë nga restoranti, duke hyrë në automjetin e markës “Fiat Punto” me ngjyrë hiri me targa të regjistrimit xx – xxx – xx dhe janë nisur në drejtim të rrugës “T.” i akuzuari me automjet iu është afruar vizavijë me automjetin e të dëmtuarëve ku i akuzuari E. S. i cili ishte i ulur në pjesën e pasme të veturës, nxjerr revolen, hap dritaren e automjetit dhe gjuan në drejtim të veturës së të dëmtuarëve 7 herë, me ç rast goditet i dëmtuari D. P. të cilit i shkaktohet plagë nga arma e zjarrit dhe ate plagë depërtuese në brylin e parakrahut të dorës së djathtë e shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së armës së zjarrit që për nga natyra bënë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin si dhe duke rrezikuar jetën e personave të tjerë të dëmtuarve U. F., D. P., E. S. dhe A. K., pas së cilës me të shpejtë largohet nga vendi i ngjarjes, derisa vetura e të dëmtuarëve nga goditja është skajuar dhe të dëmtuarit D. P. i cili ishte plagosur dërgohet në ambulancë, e më pasë në Qendrën emergjente të Spitalit të Prizrenit.

-Këso dore kryen veprën penale të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1. të KP.

3. Me datë, kohë dhe vend të njëjtë, si ne dispozitivin nën I mban në pronësi, kontroll dhe në posedim armën në shkelje me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, në atë mënyrë që në mënyrë vullnetare ka dorëzuar armën në Stacionin policor në Prizren me nr.serik LLB 6191945 të cilën armë e ka përdorur dhe e ka mbajtur në pronësi dhe posedim pa lejen përkatëse të organit kompetent.

Këso dore ka kryer veprën penale mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 te KP.

I akuzuari L. S.:

Se më datën 08.01.2015 rrethë orës 22,25 minuta në Prizren pas një mosmarrëveshje me personat-këtu të akuzuarit E. M. dhe A. F. në Lagjen “T.” në afërsi të shkollës së mesme “R. A.” ku ka ardhur deri te një përleshje mes tyre, ku pas së cilës i akuzuari L. kthehet në shtëpinë e tij lajmëron vëllaun E. S. për sulmin fizik, i ndihmon të njëjtit në kyerjen e veprës penale në atë mënyrë që me automjet të markës WV Buba me ngjyrë të kaltër metalike me targa të regjistrimit xx – xxx – xx të cilin e drejtonte ai vet, e bart – e dërgon gjer në vendin ku është kryer vepra penale, në rrugën “T.” saktësisht tek Universiteti “F.”,ashtuqë kur automjeti i tyre afrohet vizavijë me automjetin e të dëmtuarëve, ku ishin të dëmtuarit D. P., E. S., A. K. dhe U. F., i akuzuari E. S. i cili ishte i ulur në pjesën e pasme të veturës nxjerrë revolen, hap dritaren e automjetit dhe gjuan në drejtim të veturës së të dëmtuarëve 7 herë, duke e goditur të dëmtuarin D. P., në krahun e majtë dhe me të shpejtë janë larguar nga vendi i ngjarjes, ndërsa vetura e të dëmtuarëve të cilën e drejtonte A. K. nga goditja me armë është skajuar ndërsa i dëmtuari D. P. së pari është dërguar në Qendrën emergjente pas së cilës me automjetin e ndihmës së shpejtë është dërguar në spital ku edhe i është dhënë ndihma e parë, ndërsa të dëmtuarit e tjerë kanë qendruar në vendin e ngjarjes, duke e pritur policinë,

Këso dore ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë- në ndihmë nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe nenin 33 të KP.

Të akuzuarit A. F. dhe E. M.:

Më datën 08.01.2015 rrethë orës 13:00, në Prizren më konkretisht në afërsi të gjimnazit “R. A.”, si bashkëkryerës i shkaktojnë lëndim të lehtë trupor personit tjetër – të dëmtuarit L. S., në atë mënyrë që ditën kritike duke qenë me automjetin të cilin e ka drejtuar U. F., pas një mosmarrëveshjeje të mëherëshme në mes të akuzuarit E. M. dhe të dëmtuarit L. S. i cili ka qenë me automjetin e tij për momentin dhe pasiqë janë takuar në afërsi të shkollës, kanë filluar që ta fyejnë njëri tjetrin, janë parkuar jo largë shkollës me ç’ rast të akuzuarit A. F. i cili ka patur një shufër metalike në dorë dhe E. M. kanë dal nga automjeti dhe e kanë sulmuar të dëmtuarin L. i cili poashtu kishte dalë nga automjeti, duke e goditur në pjesë të ndryshme të trupit, duke u larguar nga vendi i ngjarjes, dhe se i dëmtuari L. S. për shkak të lëndimeve dërgohet në Qendrën emergjente ku hospitalozohet dhe i lëshohet raporti mjekësor me nr.656.

-Këso dore në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.1.p.l.l.lidhur me nenin 31 të KP.

Konformë nenit 364 par.1. p.1.3. të KPP i akuzuari L. S.

LIROHET NGA AKUZA

Se më datë, kohë dhe vend të njejtë i akuzuari E. S. ka shkaktuar rrezik të madh të njerëzve të pranishëm në atë mënyrë që natën kritike pas një mosmarrëveshje të mëparshme e merr automjetin e markës WV Buba me ngjyrë metalike me targa të regjistrimit xx – xxx – xx të cilin e drejton i akuzuari L. dhe kur mbrinë në afërsi të pompës së benzinës H. vërejnë automjetin e të dëmtuarit U. F. i cili ka qenë në shoqëri me D. P., E. S. dhe A. K. dhe pasi që të njejtë kanë dalë nga restoranti, duke hyrë në automjetin e markës “Fiat Punto” me ngjyrë hiri me targa të regjistrimit xx – xxx – xx dhe janë nisur në drejtim të rrugës “T.” të akuzuarit me automjetin e tyre iu janë afruar vizaviç me automjetin e të dëmtuarëve ku i akuzuari E. S. i cili ishte i ulur në pjesën e pasme të veturës, nxjerr revolen, hap dritaren e automjetit dhe gjuan në drejtim të veturës së të dëmtuarëve 7 herë, me ç rast goditet i dëmtuari D. P. të cilit i shkaktohet plagë nga arma e zjarrit dhe ate plagë depërtuese në brylin e paraprahut të dorës së djathtë e shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së armës së zjarrtë që për nga natyra bënë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin si dhe duke rrezikuar jetën e personave të tjerë të dëmtuarve U. F., D. P., E. S. dhe A. K. pas së cilës me të shpejtë largohen nga vendi i ngjarjes, derisa vetura e të dëmtuarëve nga goditja është skajuar dhe i dëmtuari D. P. i cili ishte i plagosur dërgohet në ambulancë, e më pasë në Qendrën emergjente të Spitalit të Prizrenit.

-Këso dore kishte për të kryer veprën penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1. të KP.

Andaj, gjykata konformë dispozitave të nenit 4, 7, 17, 41,45,46,62 par.2 pika 2,6,73,80,83 dhe 178 lidhur me nenin 28,365 par.1, 374 par.1 dhe 188 par.1 puika 1.1 lidhur me nenin 31 te KP i .

GJYKON

Të akuzuarin E. S.:

Per vepren penale vrasje ne tentative nga neni 178 lidhur me nenin 28 te KP me **dënim me burgim në kohëzgjatje prej 18 /tetëmbdhjetë/ muajve.**

Për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1. të KP, **me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 /tetë/ muajve.**

Andaj, gjykata konforme dispozitave të nenit 80 par.2 pika.2.2 të KP për veprat e lartëcekura penale të akuzuarit ia shqipton **dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 /dy / viteve**, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak prej datës 09.01.2015 gjerë më 05.05.2015.

Për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP me **dënim me gjobë në shumën prej 1000 /njëmijë/ Euro**, të cilin dënim me gjobë është i obliguar që ta paguajë në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Poqese dënimin me gjobë nuk e paguan në afatin e paraparë atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtuqë një ditë burgim do të llogaritet 20 Euro.

Të akuzuarin L. S.:

Për veprën penale të vrasjes në tentativë – në ndihmë nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 33 të KP, **me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 muajve**, në të cilin dënim me burgim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim - arrest shtëpiak prej datës 09.01.2015 gjerë më 05.05.2015.

Të akuzuarit E. M. dhe A. F.:

Për veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.1.p.1.1. të KP, **me dënim me gjobë secilit prej tyre shumën me nga prej 800 /tetëqindë/**, Euro, të cilin dënim me gjobë janë të obliguar që ta paguajnë në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Poqese dënimin me gjobë nuk e paguajnë në afatin e paraparë atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtuqë një ditë burgim do të llogaritet 20 Euro.

Të dëmtuarit D. P. dhe A. K. për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Nga i akuzuari E. S. konfiskohet arma me nr.serik LLB 6191945 si mjet i kryerjes së veprës penale.

Obligohen të akuzuarit E. dhe L. S. që secili prej tyre të paguajnë shpenzimet e procedurës penale – paushalin gjyqësor në shumën prej nga 600 Euro ndërsa të akuzuarit A. F. dhe E. M. secili prej tyre shumën prej nga 150 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria e Shtetit në Prizren kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.nr.2/15 të datës 03.03.2015 kundër të akuzuarve E. S. dhe L. S. për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KP, të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1.lidhur me nenin 31 të KP, E. S. për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KP si dhe të akuzuarve A. F. dhe E. M. për shkak të veprës penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika..1.1. lidhur me nenin 31 të KP. Në fjalën përfundimtare Prokurori i Shtetit Genc Nixha të cilën e ka parashtruar në formën e shkruar gjatë elaborimit verbal ka deklaruar se sa i përket të akuzuarve E. dhe L. S. gjendja faktike është vërtetuar kryesisht nga deklaratat e tyre në prokurori si dhe në shqyrtimin gjyqësor të cilët kanë pranuar se kanë patur një mosmarrëveshje me E. M. dhe A. F. Kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe nga deklaratat e të akuzuarve A. F. dhe E. M. të cilët në Prokurorinë e shtetit kanë pranuar se ditën kritike janë zënë me të akuzuarin L. dhe të njejtin e kanë sulmuar. Poashtu edhe të dëmtuarit U. F., D. P., E. S. dhe A. K. kanë përshkruar rastin se si janë sulmuar duke qenë në automjet.

Sa i përket të akuzuarve E. M. dhe A. F. të njejtin prej fillimit kanë pranuar përgjegjësinë për veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.1.p.1.1. lidhur me nenin 31 të KP. Andaj, ka propozuar që të akuzuarit të shpallen fajtor për veprat penale të cilat iu vihen në barrë me aktakuzë dhe të dënohen sipas ligjit. Konformë nenit 62 pa.2.p.2.6, në lildhje me nenin 69 par.1. të KP ka propozuar konfiskimin e armës nga i akuzuari E. S. si objekt i kryerjes së veprës penale. Poashtu, ka propozuar që gjatë matjes së dënimit gjykata ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat duhen të jenë në proporcion me peshën e veprës penale sjelljet dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit E. S., avokat S. M. ka deklaruar se gjatë shqyrtimeve kryesore nuk është vërtetuar se i akuzuari E. S. e ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KP.I akuzuari nuk ka patur qëllim dhe dashje që personat e panjohur ti privoi nga jeta dhe se në këto raste duke patur parasysh praktikën gjyqësore të kësaj gjykate dhe të kësaj prokurorie aplikohen dispozitat e nenit 375 të KP që do të thotë përdorimi i armës në mënyrë të rrezikshme. Andaj, konsideron se vepra për të cilën akuzohet i akuzuari nuk mund të qëndroi. Sa i përket veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm dhe arëmbajtjes pa leje këto nuk janë kontestuese, pasi që të njejtat vepra i ka pranuar. Andaj, propozon që gjykata të akuzuarin E. S. në mungesë të provave ta liroi nga përgjegjësia për veprën penale të vrasjes në tentativë ndërsa, për dy veprat e cekura penale ta shpallë fajtor pasi që nga fillimi i shqyrtimit e ka pranuar fajsinë. Me pohimet e mbrojtësit është pajtuar edhe i akuzuari E. S.

Mbrojtësi i të akuzuarit L. S. avokat F. Sh. fjalën përfundimtare gjykatës ia ka parashtruar në formën e shkruar dhe se gjatë elaborimit ka theksuar se me asnjë provë nuk është vërtetuar dhe argumentuar se i akuzuari ka kryer veprat penale të cilat i vehen në barrë. I akuzuari nuk ka ndërmarrë asnjë veprim që do të konsistonte në kryerjen e veprave penale dhe se nuk ka prova të mjaftueshme të cilat mund të vërtetojnë se i njejtin ka kryer këto vepra penale vet ose si bashkëkryerës. Ditën kritike i akuzuari L. S. nuk ka ndërmarrë asnjë veprim kundër të akuzuarëve as nuk ka patur armë me vehte e as ndonjë mjet tjetër të rrezikshëm çka nënkupton se nuk ka mundur edhe ti përdor pasi që për ekzistimin e këtyre veprave penale siq pretendohet në aktakuzë një person për të kryer

veprën penale të vrasjes në tentativë kërkohet që të ndërmerr personalisht ndonjë veprim kundërligjor ndaj personit të caktuar. Në rastin konkret mungon lidhja shkakore në mes të veprimit të akuzuarit dhe pasojës ashtu siq parasheh neni 20 i KP. Sa i përket bashkëkryerjes në kuptim të nenit 31 të KP është dashur që në mënyrë të saktë dhe domosdo të vërtetohet kohezioni respektivisht lidhshmëria subjektive në mes të dy të akuzuarëve në kryerjen e veprës penale e cila në rastin konkret nuk ka ndodhur, andaj, ka propozuar që i akuzuari L. S. të lirohet nga akuza pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet. Me pohimet e mbrojtësit është pajtuar edhe i akuzuari L. S.

I akuzuari E. M. i ka propozuar trupit gjykues që ti shqiptohet një dënim së më i butë duke marrë parasysh se e ka pranuar fajsinë për veprën penale në shqyrtimin fillestar dhe se është përdur për veprimet e kryera.

Poashtu edhe i akuzuari A. F. ka shpreh pendim për veprimet e kryera duke i propozuar trupit gjykues që të ia shqiptoi një dënim sa më të butë.

Për vërtetimin e drjetë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje gjykata gjatë procedurës së provave ka ndëgjuar të dëmtuarit E. S., D. P., A. K. dhe U. F., ka lexuar listën e armëve të konfiskuara me nr.2015-GA-0073 të datës 09.01.2015, raportet mjekësore të datës 01.08.2015 me nr.647 dhe të datës 09.01.2015 me nr.656, është lexuar raporti i forenzikës me nr.2015-GA 0073 të dtës 09.01.2015, është lexuar lista e dëshmive në lidhje 2015-GA 0073 në lidhje me mostrën GSR e të akuzuarit L. S. Është bërë shiqimi në listën e dëshmive 2015-GA-0073, është bërë shiqimi në skicën nga vendi i ngjarjes dhe fotodokumentacioni si dhe është lexuar eksertiza mjeko ligjore e zyrës e datës 13.02.2015 si dhe janë marrë në pyetje të akuzuarit E. dhe L. S.

I dëmtuari E. S. gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 19.10.2015 ka ngelur në tërësi pranë deklaratës së dhënë në prokurori më datën 06.02.2015 duke cekur se të akuzuarin E. S. nuk e njeh dhe se nuk ka patur ndonjëherë problem me te, e poashtu të akuzuarin L. S. nuk e njeh. Në vendin e ngjarjes kur janë nis me veturë ka dëgjuar 4-5 të shtëna. Nuk din se sa persona kanë qenë në automjet sepse pasi i ka ndëgjuar të shtënat e ka ulë kokën. Poashtu ka cekur se nuk din se U. F. a ka pas problem me L. dhe me E. Si i dëmtuar nuk ka parashtruar kërkesë pasuroro- juridike.

I dëmtuari D. P. poashtu ka qendruar pranë deklaratës së dhënë në prokurori më datën 06.02.2015 dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk e njeh as E. e as L. S. dhe se ditën kritike ka dëgjuar 5, 6 apo 7 krisma, ka qenë i plagosur në fillim dhe pastaj nuk ka vërejtë asgjë. Ka marrë lëndime nga arma në dorën e djathtë, ka qenë në Qendrën emergjente dhe se si i dëmtuar ka parashtruar kërkesë pasuroro-juridike.

I dëmtuari A. K. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka ngelë pranë deklaratës së dhënë në PSH më datën 06.02.2015 duke cekur se të akuzuarin E. S. e njeh si figurë dhe se asnjëherë nuk ka kontaktuar me te. Natën kritike kur i ka ndëgjuar krismat nuk ka mund që të vërej edhe se kush ka qenë në veturë dhe se që L. me E. kanë qenë në veturë ka kuptuar në stacionin policor. Nuk e din se L. a ka patur ndonjëherë problem me U. dhe se natën kritike i njëjti ka pësuar lëndim – një gërvishje në këmbë mirëpo, nuk e din se si –

prej çkafit. Dy javë pas rastit të ndodhur është takuar me L. dhe E. dhe janë pajtuar. Si i dëmtuar ka parashtruar kërkesë pasuroro-juridike.

I dëmtuari U. F. ka deklaruar se të akuzuarin E. S. nuk e njeh dhe nuk ka patur ndonjë problem me te dhe se natën kritike nuk ka mundur që ti dalloj personat në veturë. Të akuzuarin L. e njeh por me të nuk ka patur ndonjëherë ndonjë problem. Natën kritike që janë gjuajtë me armë L. S. ka patur problem me E. M., mirëpo, nuk e din se çfarë problemi ka pasë dhe se derisa ai ka qenë me E. në automjet në automjetin tjetër vizavijë me të ka qenë L. S. dhe se E. M. e ka hap dritaren e automjetit, janë fjalos janë shajhtë në mes vedi dhe se E. ka gjuajtë me shishe të plastikës në drejtim të L. Në atë moment L. e ka ndalë automjetin, nga automjeti kanë dalë edhe E. dhe A. F. dhe janë rrahur në mes vedi në Lagjen “T.” dhe se kjo ka ndodhur tri – katër orë para rastit kritik. Si i dëmtuar nuk ka parashtruar kërkesë pasuroro-juridike.

Nga lista e armëve të konfiskuara me nr.2015-GA-0073 të datës 09.01.2015 vërtetohet se nga i akuzuari E. S. është konfiskuar një pistoletë e markës CCCP me nr.serik UB 619-1945.

Nga skica e vendit të ngjarjes dhe nga fotografitë nga fotoalbumi i bashkangjitur shkresave të lëndës shihet pamja e vendit të ngjarjes në rrugën “T.” në Prizren dhe dëshmitë e mbledhura nga vendi i ngjarjes sipas listës së dëshmive e që janë një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim II- 64, një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim II-64, një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim 11- 64, një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim 11- 64, një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim 11- 64, një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim 11- 64, një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim 11- 64, një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim 11- 64, të gjitha këto të gjetura në vendin e ngjarjes, një predhë fisheku e gjetur në dyshejen e pasme të veturës, një mbështjellës i predhës në derë të shoferit dhe një predhë fisheku në dysheje të shoferit në veturën e markës “Fiat Punto” me targa të regjistrimit xx-xxx-xx.

Nga lista e dëshmive me nr.2015-GA-0073 e datës 08.01.2015 vërtetohet se nga i akuzuari L. S. janë marrë mostrat GSR shtup magnetike nga pjesa e sipërme e dorës së djathtë, nga shuplaka e dorës së djathtë, nga pjesa e sipërme e dorës së majtë dhe nga shuplaka e dorës së majtë, mirëpo, nuk ka ndonjë raport në lidhje me mostrat e marra.

Sipas ekspertizës së ekspertit Dr. M. G. në lidhje me lëndimet e të dëmtuarit D. P. dhe të akuzuarit L. S., i njëjti akt ekspertimin e tij e ka bazuar në raportin mjekësor të emergjencës – Spitalit rajonal në Prizren me nr. të protokolit 647 për të dëmtuarin D. P. në bazë të cilit raport ka dhënë mendimin e vet se dëmtimet e përshkruara paraqesin plagë nga armë zjarri depërtuese në nyjen e brylit – parakrahut të dorës së djathtë, të cilat dëmtime janë të shkaktuara nga veprimi dinamik i predhës së armës së zjarrit dhe se për nga natyra këto dëmtime bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Poashtu, sipas raportit të emergjencës, Spitalit rajonal në Prizren me nr. protokoli 656 për të akuzuarin L. S. ka theksuar në mendimin e vet se dëmtimet e përshkruara në raport paraqesin ndrydhje në kokë dhe në hundë të cilat janë të shkaktuara

nga veprimi mekanik i trupit të fortë mbretës, jo të mpreht dhe për nga natyra e tyre bëjnë pjesë në lëndime të lehta me pasoja të përkohshme për shëndetin.

I akuzuari E. S. në mbrojtjen e vet gjatë shqyrtimit gjyqësor ka ngelur pranë deklaratës së dhënë në prokurori duke cekur se të dëmtuarit E. P., D. P., A. K. dhe U. F. nuk i njef e as E. M. dhe A. F. Ditën kritike më datën 08.01.2015 ka dalë me vëllauin e tij, kanë qenë me veturë dhe derisa kanë qenë duke u sjell diku te “H. P.”, vëllau i tij e ka vërejtur veturën e të dëmtuarit U. F. Kanë lëvizur me automjetet deri tek firma “E.”, pastaj janë kthyer përsëri dhe në një moment ka vërejtur se të dëmtuarit janë duke dalë nga restorani. I është afruar me automjetet, kanë qenë viza-vijë me automjetin e tyre dhe se qëllimi i tij ka qenë që ti ndalë dhe të bisedojnë rrethë problemit që ka patur vëllau-L. Mirëpo, prej frigës e ka nxjerr revolen dhe ka gjuajtur përpjetë 4 – 5 herë. Qëllimi i tij nuk ka qenë që ta vret dikent, mirëpo që ta ndalë automjetin dhe të bisedojnë dhe se armën e ka marrë me vehte pasiqë vëllau i tij L. i ka thënë se janë 4 – 5 persona. Automjetin ka qenë duke e drejtuar vëllau i tij – L. ndërsa ai vet ka qenë në ulësen e prapme pasiqë karrika e bashkëudhëtarit nuk ka qenë në rregullt. Të dëmtuarit E. S. dhe D. P. nuk i njeh fare.

I akuzuari L. S. në mbrojtjen e tij ka theksuar se ditën kritike tek shkolla “R. A.”, e kanë sulmuar U. F., A. F. dhe E. M. dhe atë me një shufër të hekurt dhe me grushta me ç rast ka marrë lëndime në kokë dhe në hundë. Pas kësaj ka shkuar në shtëpi mirëpo, E. nuk ka ditur për këtë e as ky nuk ka qenë në dijeni që E. ka patur me vehte armën dhe se kur kanë qenë viza-vijë me automjetin e të dëmtuarve tek “H. P.” ka vërejt U. që ka nxjerr diçka, mirëpo, nuk e din se çka, iu është drejtuar vëllaut me fjalë “janë tue dashtë me bo diçka” dhe në atë moment ka ndëgjuar krismën e armës me të cilën ka gjuajtur vëllau i tij.

Në bazë të provave të lartëcekura, pas vlerësimit të secilës provë një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se i akuzuari E. S. më datën 08.01.2015 rrethë orës 22,25 minuta në Prizren në rrugën “T.” saktësisht tek Universiteti “F.” me dashje ndërmerr veprime me qëllim të privimit nga jeta të personit tjetër në rastin konkret të dëmtuarve D. P., E. S., A. K. dhe U. F., në atë mënyrë që pasi i akuzuari L. S. kishte pas një mosmarrëveshje me personat e quajtur E. M. dhe A. F. në Lagjen “T.” në afërsi të shkollës së mesme “R. A.,” ku ka ardhur deri në një përleshje mes tyre ku pas së cilës i akuzuari L. kthehet në shtëpinë e tij lajmëron vëllauin E. S. për sulmin fizik pas së cilës që të dy në një automet të markës WV-Buba me ngjyrë të kaltër metalike me targa të regjistrimit xx – xxx – xx të cilën e ka drejtuar i akuzuari L. kanë dalë në qytet për ti kërkuar të akuzuarit E. M., A. F. dhe të dëmtuarin U. F. dhe kur kanë mbërritur në afërsi të pompës së benzinës H. vërejnë automjetin e të dëmtuarit U. F., i cili ka qenë në shoqëri me D. P., E. S. dhe A. K. dhe pasiqë të njejtit kanë dalë nga restoranti, kanë hyrë në automjetin e markës “Fiat Punto” me ngjyrë hiri me targa të regjistrimit xx-xxx – xx, janë nisur në drejtim të rrugës “T.” të akuzuarit me automjetin e tyre iu janë afruar vizavijë me automjetin e të dëmtuarëve ku i akuzuari E. S. i cili ishte i ulur në pjesën e pasme të veturës nxjerrë revolen, hap dritaren e automjetit dhe gjuan në drejtim të veturës së të dëmtuarëve 7 herë, duke e goditur të dëmtuarin D. P., në krahun e majtë dhe me të shpejtë janë larguar nga vendi i ngjarjes, ndërsa vetura e të dëmtuarëve të cilën e drejtonte A. K. nga goditja me armë është skajuar ndërsa i dëmtuari D. së pari është dërguar në Qendrën emergjente pas së cilës me automjetin e ndihmës së shpejtë është

dërguar në spital ku edhe i është dhënë ndihma e parë, ndërsa të dëmtuarit e tjerë kanë qendruar në vendin e ngjarjes, duke e pritur policinë.

Gjendjen e këtillë faktike gjykata e vërtetoi në bazë të deklaratave të demtuarve të cilët përkundër faktit që kanë deklaruar se nuk kanë qenë në gjendje që të vërejnë se kush ka qenë në vetur, kanë deklaruar se kanë ndëgjuar krismat – të shtënat e armës. Kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe nga vet deklarata e të akuzuarit E. S. i cili nuk e ka mohuar faktin se natën kritike ka gjuajtur me armë në drejtim të automjetit ku kanë qenë të dëmtuarit, e që kjo përputhet edhe me provat materijale të gjetura në vendin e ngjarjes, skica e vendit të ngjarjes, fotografitë nga fotoalbumi dhe dëshmitë e mbledhura nga vendi i ngjarjes sipas listës së dëshmitëve e që janë një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim II- 64, një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim II-64, një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim 11- 64, një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim 11- 64, një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim 11- 64, një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim 11- 64, një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim 11- 64, një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim 11- 64, një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim 11- 64, një gëzhgjë fisheku kal. i panjohur me mbishkrim 11- 64, të gjitha këto të gjetura në vendin e ngjarjes, një predhë fisheku e gjetur në dyshejen e pasme të veturës, një mbështjellës i predhës në derë të shoferit dhe një predhë fisheku në dysheje të shoferit në veturën e markës “Fiat Punto” me targa të regjistrimit xx-xxx-xx. Poashtu, kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe nga raporti i Qendrës emergjente dhe nga ekspertiza e ekspertit mjeko-ligjor Dr. M. G. në lidhje me lëndimet e të dëmtuarit D. P., e që janë lëndime të shkaktuara nga arma e zjarrit.

Mbrojtjes së të akuzuarit E. S. se i njëjti nuk ka patur për qëllim që ta vret askend, gjykata nuk ia fali besimin nga arsyeja se i njëjti ditën kritike është pajisur me armë, ka shkuar në vendin e ngjarjes dhe pasiqë i ka vërejt të dëmtuarit që kanë hypur në automjet dhe kur automjeti i tyre ka qenë viza-vijë me të akuzuarit, e ka hapur dritaren dhe ka gjuajtur në drejtim të tyre 7 herë, e që sipas gjykatës në veprimet e tija ka ekzistuar dashja për kryerjen e veprës penale, pasiqë nga një afërsi e vogël ka gjuajtur në drejtim të dëmtuarëve dhe ate 7 herë, gjë që tregon edhe vendosmërinë e tij për kryerjen e veprës penale. Andaj, edhe bazuar në këto fakte gjykata ka ardhur në përfundim dhe ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit E. S. formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KP për çka edhe të njëjtin e shpalli fajtor dhe ia shqiptoi dënimin me burgim si në dispozitiv.

Në bazë të pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit E. S. gjykata ka vërtetuar se në veprimet e tij formohen elementet qenësore të veprës penale shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1. të KP, se më datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin nen I të ketij aktgjykimi i akuzuari E. S. ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve në atë mënyrë që natën kritike pas një mosmarrëveshje të mëparshme e merr automjetin e markes WV- Buba me ngjyrë metalike me targa të regjistrimit xx – xxx – xx të cilin e drejton i akuzuari L. dhe kur mbërrin në afërsi të pompës së benzinës “H.” vërenë automjetin e të dëmtuarit U. F. i cili ka qenë në shoqëri me D. P., E. S. dhe A. K. dhe pasi që të njëjtit kanë dalë nga restoranti, duke hyrë në automjetin e markës “Fiat Punto” me ngjyrë hiri me targa të regjistrimit xx – xxx – xx dhe janë nisur në drejtim të rrugës “T.” i akuzuari me automjetin e tyre është afruar vizavijë me automjetin e të dëmtuarëve ku i akuzuari E. S. i cili ishte i ulur në pjesën e pasme të veturës, nxjerr revolen, hap dritaren e automjetit dhe gjuan në drejtim të veturës së të dëmtuarëve 7 herë,

me ç rast goditet i dëmtuari D. P. të cilit i shkaktohet plagë nga arma e zjarrit dhe ate plagë depërtuese në brylin e parakrahut të dorës së djathtë e shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së armës së zjarrit që për nga natyra bënë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin si dhe duke rrezikuar jetën e personave të tjerë të dëmtuarve U. F., D. P., E. S. dhe A. K., pas së cilës me të shpejtë largohet nga vendi i ngjarjes, derisa vetura e të dëmtuarëve nga goditja është skajuar dhe të dëmtuarit D. P. i cili ishte plagosur dërgohet në ambulancë, e më pasë në Qendrën emergjente të Spitalit të Prizrenit.

Poashtu në bazë të pranimit gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit E. S. formohen elementet qenësore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KP, pasiqë me datë kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin nën l/, të këtij aktgjykimi mban në pronësi, kontroll dhe në posedim armën në shkelje me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, në atë mënyrë që në mënyrë vullnetare ka dorëzuar armën në Stacionin policor në Prizren me nr. serisë LLB 6191945 të cilën armë e ka përdorur dhe e ka mbajtur në pronësi dhe posedim pa lejen përkatëse të organit kompetent.

Gjykata e ka aprovuar pranimin e fajsisë së të akuzuarit E. S. për të dy veprat e lartëcekura penale pasiqë pranimi i fajsisë është bërë konforme nenit 248 e KPP pasiqë i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, pranimi i fajsisë është bërë vullnetarisht pas konsultimit me mbrojtësin e tij dhe se pranimi i fajsisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor për të tri veprat e lartëcekura penale duke ia shqiptuar për secilën vepër penale dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe se me aplikimin e dispozitave të dënimit për bashkim të veprave penale konformë nenit 80 par.2 pika 2.të KP ia shqiptoi dënimin unik për të dy veprat e lartëcekura penale – të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KP dhe veprës penale të shaktimit të rrezikshëm nga neni 365 par.1. të KP,duke e gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 /dy/ viteve, ndërsa për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KP me dënim me gjobë në shumën prej 1000 /njëmijë Euro.

Sa i përket të akuzuarit L. S. pas administrimit të provave të lartëcekura dhe vlerësimit të tyre gjykata e ka bërë ricilësimin e veprës penale nga vepra penale e vrasjes në tentativë në bashkëkryerje nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KP ashtu si është akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë së Shtetit, në veprën penale të vrasjes në tentativë në ndihmë nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 33 të KP.Kjo nga fakti se nga provat e lartëcekura është vërtetuar se i akuzuari L. S. e ka ndihmuar të akuzuarin E. S. në kryerjen e veprës penale ashtuqë të akuzuarit E. ia ka vënë në dispozicion mjetin – automjetin, të njëjtin e ka bart – dërguar gjer në vendin ku është kryer vepra penale me ç rast edhe i akuzuari E. ka shtënë me armë në drejtim të dëmtuarëve. I akuzuari L. S. fare nuk ka qenë në dijeni se vëllau i tij e ka patur me vehte armën, andaj, duke marrë parasysh të lartëcekurat gjykata të njëjtin edhe e shpalli fajtor për veprën penale të vrasjes në tentativë në ndihmë nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 33 të KP dhe ia shqiptoi dënimin me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasiqë vërtetoi se -më datën 08.01.2015 rrethë orës 22,25 minuta në Prizren pas një mosmarrëveshje me E. M. dhe A.

F. në Lagjen “T.” në afërsi të shkollës së mesme “R. A.,” ku ka ardhur deri te një përleshje mes tyre, ku pas së cilës i akuzuari L. kthehet në shtëpinë e tij lajmëron vëllaun E. S. për sulmin fizik, i ndihmon të njejtin në kryerjen e veprës penale në atë mënyrë që me automjetin të markës WV Buba me ngjyrë të kaltër metalike me targa të rregjistruar xx – xxx – xx të cilin e drejtonte ai vet e bart – e dërgon gjer në vendin ku është kryer vepra penale, në rrugën “T.” saktësisht tek Universiteti “F.,” ashtuqë kur automjeti i tyre afrohet viza-vijë me automjetin e të dëmtuarëve, ku ishin të dëmtuarit D. P., E. S., A. K. dhe U. F., i akuzuari E. S. i cili ishte i ulur në pjesën e pasme të veturës nxjerrë revolen, hap dritaren e automjetit dhe gjuan në drejtim të veturës së të dëmtuarëve 7 herë, duke e goditur të dëmtuarin D. P., në krahun e majtë dhe me të shpejtë janë larguar nga vendi i ngjarjes, ndërsa vetura e të dëmtuarëve të cilën e drejtonte A. K. nga goditja me armë është skajuar ndërsa i dëmtuari D. së pari është dërguar në Qendrën emergjente pas së cilës me automjetin e ndihmës së shpejtë është dërguar në spital ku edhe i është dhënë ndihma e parë, ndërsa të dëmtuarit e tjerë kanë qëndruar në vendin e ngjarjes, duke e pritur policinë.

Gjykata ka vërtetuar se i akuzuari L. S. me veprimet e lartëcekura i ka ndihmuar të akuzuarit E. S. në kryerjen e veprës penale të vrasjes në tentativë, në atë mënyrë që ka vënë në dispozicion mjetin – automjetin, e ka bartë dhe dërguar të njejtin gjerë në vendin ku edhe është kryer vepra penale. Konformë nenit 33 par.1. të KP kushdo që me dashje ndihmon personin tjetër për kryerjen e veprës penale dënohet me dënim më të butë. Andaj, bazuar në këtë gjykata të akuzuarit L. S. ia ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 muajve.

Konformë nenit 365 par.1. të KP kushdo që me anë të zjarrit, vërshimeve, eksplozivit, helmit ose gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës mekanike me energji elektrike ose me ndonjë lloj energjie tjetër ose me ndonjë veprim tjetër të rrezikshëm apo mjete të rrezikshme shkakton rrezik të madhë për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror kryen veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm.

Në rastin konkret në bazë të provave të lartëcekura veprimin me mjetin e rrezikshëm – me armë e ka ndërmarrë i akuzuari E. S. i cili ka gjuajtur në drejtim të automjetit të dëmtuarëve me ç rast ka shkakuar lëndime trupore të dëmtuarit D. P. si dhe ka rrezikuar personat tjerë – të dëmtuarit tjerë që kanë qenë prezent. Pasiqë në rastin konkret në lidhje me këtë veprë penale nuk është provuar – nuk është vërtetuar se çfarë veprimesh ka ndërmarrë i akuzuari L. S., gjykata edhe të njejtin e liroi nga akuza sa i përket kësaj veprë penale pasi që nuk gjeti se ndërmjet veprimit të kryerjes dhe pasojës së shkakuar ekziston një raport shkaksor në lidhje me të akuzuarin L. S.

Pasiqë të akuzuarit A. F. dhe E. M. qysh në shqyrtimin fillestar e kanë pranuar fajsinë, gjykata në bazë të pranimit të fajsisë ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarëve A. F. dhe E. M. formohen elementet qenësore të veprës penale të lëndimit të lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.1.p.1.1. lidhur me nenin 31 të KP, pasi që më datën 08.01.2015 rreth orës 13:00, në Prizren më konkretisht në afërsi të gjimnazit “R. A.,” si bashkëkryerës i shkaktojnë lëndim të lehtë trupor personit tjetër – të dëmtuarit L. S., në atë mënyrë që ditën kritike duke qenë me automjetin të cilin e ka drejtuar U. F., pas një mosmarrëveshjeje të mëherëshme në mes të akuzuarit E. M. dhe të dëmtuarit L. S. i cili ka qenë me automjetin e tij për momentin dhe pasi që janë takuar në afërsi të shkollës,

kanë filluar që ta fyejnë njeri tjetrin, janë parkuar jo largë shkollës me ç rast të akuzuarit A. F. i cili ka patur një shufër metalike në dorë dhe E. M. kanë dalë na automjeti dhe e kanë sulmuar të dëmtuarin L. i cili poashtu kishte dalë nga automjeti, duke e goditur në pjesë të ndryshme të trupit, duke u larguar nga vendi i ngjarjes, dhe se i dëmtuari L. S. për shkak të lëndimeve dërgohet në Qendrën emergjente ku hospitalozohet dhe i lëshohet raporti mjekësor me nr.656.

Gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë së të akuzuarve A. F. dhe E. M. për veprën e lartëcekur penale, pasi që pranimi i fajësisë është bërë konforme nenit 248 te KPP të njejtit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bere vullnetarisht dhe se pranimi i fajësisë mbështetet me faktet e qeshtjes qe permban aktakuza. Andaj, edhe gjykata të njejtëve iu shqiptoi dënimin si në dispozitiv.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konformë nenit 73 të KP, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njejtën duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë, motivet nga të cilat është kryer vepra, prej rrethanave lehtësuese sa i përket të akuzuarit E. S. morri parasysh qëndrimin e tij korrekt, pranimin e fajësisë për dy veprat penale, moshën relativisht të re dhe pendimin për kryerjen e veprës penale. Sa i përket të akuzuarit L. S. si rrethana lehtësuese morri parasysh qëndrimin e tij korrekt, pendimin për kryerjen e veprës penale dhe moshën relativisht të re si dhe faktin se të akuzuarit E. S. dhe L. S. janë pajtuar me të dëmtuarit. Sa i përket të akuzuarve A. F. dhe E. M. si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se që të dytë qysh në shqyrtimin fillestar e kanë pranuar fajësinë për veprën penale, moshën e tyre të re dhe pendimin për veprën e kryer. Ndërsa prej rrethanave rënduese sa i përket të akuzuarit E. S. peshën dhe natyrën e veprave penale-kemi të bëjmë me veprën penale të drejtuar kundër jetës së njerëzve-vlera të shoqërisë të cilat janë të mbrojtura me ligj, mënyrën e kryerjes-i akuzuari ka gjuajtur 7 herë në drejtim të dëmtuarëve të cilët kanë qenë duarthatë pa kurrfarë mjeti apo arme në dorë. Pasi që rrethana rënduese nuk gjeti për të akuzuarit e tjerë të lartëcekur, andaj, është mendimi i gjykatës që dënimet e shqiptuara do ta arrijnë qëllimin e vet konformë nenit 41 të KPK, se dënimi i shqiptuar është në harmoni me intenzitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe se do të mundësoj një balans të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarve ti mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale. Gjykata është e mendimit se dënimi i shqiptuar të akuzuarve është në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaqërisht të asaj të posaçme, se do të ndikoj në forcimin e moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe është në pajtueshmëri me kërkesat për siguri personale të popullatës së kësaj treve dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KP në të gjitha segmentet e tij. Dënimet e shqiptuara për kah lloji dhe lartësia janë në harmoni me rrethanat e rastit, të nevojshme dhe të mjaftueshme për tu arritur qëllimi i dënimit konform dispozitës së lartëcekur. Dënimi i shqiptuar të akuzuarve sipas gjetjes së gjykatës është në harmoni dhe në baraspeshë me peshën e veprave të kryera penale dhe se kur të mirret parasysh shkalla e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyra dhe rrethanat e kryerjes së veprave penale, dënimet e këtylla paraqiten si të domosdoshme me qëllim të arritjes së qëllimit të dënimit, me to shprehet gjykimi i shoqërisë për shkak të veprës së kryer penale dhe forcohet obligimi i respektimit të ligjit.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi kërkesën pasuroro-juridike është marrë konformë nenit 463 par.2.të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 450 par.2 pika 2. 6 në lidhje me nenin 453 par.1. të KPP.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për Krime të Rënda
Më dt.05.01.2016. P.nr.36/15

Proçesmbajtësja
Sheqere Braha

Kryetarja e trupit gjykues
Ajser Skenderi

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, **Gjykatës së Apelit në Prishtinë**, nëpërmjet të kësaj gjykate.